



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr. 67**

**19 qershor**

**2012**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i BSH nr. 27, datë 16.5.2012	Për miratimin e rregullores “Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë” .....	3227
Vendim i BSH nr. 28, datë 16.5.2012	Për një shtesë në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë” .....	3233
Vendim i BSH nr. 29, datë 16.5.2012	Për miratimin e rregullores “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat” .....	3234
Vendim i BSH nr. 37, datë 29.5.2012	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarive shtesë nga Banka Raiffeisen sh.a.....	3245

**VENDIM**  
**Nr. 27, datë 16.5.2012**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES**  
**“PËR KRIJIMIN, LICENCIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BANKËS URË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe nenit 81/1 pika 1 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për krijimin, licencimin dhe funksionimin e bankës urë”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e kësaj rregulloreje në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

**KRYETARI**  
**Ardian Fullani**

**RREGULLORE**  
**PËR KRIJIMIN, LICENCIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BANKËS URË**

**KREU I**  
**TË PËRGGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve të krijimit, licencimit dhe funksionimit të bankës urë.

**Neni 2**  
**Baza ligjore**

1. Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:
  - a) nenit 12 shkronja “a” dhe nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji “Për Bankën e Shqipërisë”); dhe
  - b) nenit 81 shkronja “e”, nenit 81/1 pika 1, nenit 81/3 pika 2 dhe nenit 81/4 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji “Për bankat”).

**Neni 3**  
**Subjektet**

Subjekt i kësaj rregulloreje është banka urë.



#### Neni 4 **Përkufizimet**

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat dhe përkufizimet e përdorura në ligjin “Për bankat” dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termi i mëposhtëm do të ketë këtë kuptim:

“Bankë me probleme/bankë e dobët”- është banka që, sipas vlerësimit të Bankës së Shqipërisë, ka ose mund të ketë një përkeqësim të likuiditetit ose të aftësisë paguese të saj, si dhe nëse nuk realizohet në vazhdimësi një përmirësim në burimet e saj financiare, në profilin e rrezikut, në drejtimin strategjik të biznesit, në aftësitë dhe/ose cilësinë e drejtuesve për administrimin e rrezikut. Për qëllime të kësaj rregulloreje dhe në varësi të situatës faktike, në termin “bankë me probleme/bankë e dobët” do të përfshihen edhe bankat e vendosura në kujdestari ose likuidim nga Banka e Shqipërisë.

### KREU II KRIJIMI DHE LICENCIMI I BANKËS URË

#### Neni 5 **Krijimi i bankës urë**

1. Banka urë është një shoqëri aksionere.
2. Banka urë administron përkohësisht aktivet dhe detyrimet e transferuara nga një bankë me probleme.
3. Propozimi për krijimin e bankës urë përgatitet nga Grupi Mbikëqyrës, i cili asiston administratorët dhe/ose administrimin e bankës urë, gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

#### Neni 6 **Kriteret e krijimit të bankës urë**

1. Banka urë krijohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - a) kapitali i nevojshëm dhe kostot e tjera për të vepruar si bankë urë nuk tejkalojnë shumën e kostove që parashikohen në rastet e vendosjes së bankës në kujdestari ose likuidim;
  - b) vazhdimi i veprimtarive të bankës me probleme është i domosdoshëm për shmangien/zvogëlimin e rrezikut sistematik dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

#### Neni 7 **Regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit**

1. Vendimi për krijimin e bankës urë, si dhe statuti i saj depozitohen në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
2. Banka e Shqipërisë miraton statutin e bankës urë dhe çdo ndryshim të tij.

#### Neni 8 **Karakteristikat e licencës**

1. Licenca e bankës urë është licencë e kufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patjetërsueshme.

2. Licenca ka si pjesë përbërëse të saj aneksin e veprimtarive bankare dhe/ose financiare, të cilat do të ushtrohen nga banka urë pas plotësimit të kushteve të licencimit të përcaktuara në këtë rregullore.

3. Licenca e bankës urë është e të njëjtit format si licenca që lëshon Banka e Shqipërisë për bankat dhe degët e bankave të huaja.

4. Licenca dhe aneksi i licencës të bankës urë nënshkruhen nga Guvernatori i Bankës së Shqipërisë.

5. Përbri emrit të bankës urë duhet të pasqyrohet edhe termi “bankë urë”.

#### Neni 9

##### **Afati i licencimit të bankës urë**

Banka e Shqipërisë licencën bankën urë jo më vonë se 5 ditë pas regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

#### Neni 10

##### **Transferimi i aktiveve dhe detyrimeve**

1. Pas krijimit të bankës urë dhe marrjes së licencës, një pjesë e aktiveve dhe detyrimeve të bankës me probleme i transferohen bankës urë, me kushtin që vlera totale e detyrimeve të transferuara në bankën urë të mos jetë më e madhe se vlera totale e aktiveve/të drejtave të transferuara.

2. Në rastet kur detyrimet që i transferohen bankës urë nga banka me probleme janë më të mëdha se sa të drejtat/aktivet, diferenca mund të plotësohet nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave.

3. Detyrimet që i transferohen bankës urë përbëhen kryesisht nga depozitat e siguruar të bankës me probleme, por pa u kufizuar vetëm në to.

4. Bankës urë nuk mund t’i transferohen aktivet e mëposhtme:

a) kredi të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes më shumë se 90 ditë;

b) kreditë e fshira;

c) aktive, të cilat janë të vështira për t’u arkëtuar (kreditë konsumatore, overdraft-et për individë, kartat e kreditit etj.);

d) aktive të bankës me probleme, vlera e të cilave është vështirë të përcaktohet;

e) aktive të tjera, të cilat vlerësohen si aktive jo cilësore për t’u transferuar tek banka urë;

f) kreditë e dhëna për personat e lidhur me bankën me probleme ose bankën e vendosur në kujdestari/likuidim.

5. Marrëveshja e transferimit të aktiveve dhe detyrimeve miratohet paraprakisht nga Banka e Shqipërisë dhe nënshkruhet nga administratori i bankës urë dhe kujdestari/likuidatori.

#### Neni 11

##### **Veprimtaritë e bankës urë**

1. Banka urë ushtron veprimtari bankare dhe/ose financiare siç përcaktohet në vendimin e Bankës së Shqipërisë për krijimin e saj, në përputhje me përcaktimet e ligjit “Për bankat”, të kuadrit rregullativ të Bankës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

2. Banka urë nuk synon rritjen e depozitave, por kufizimin në pranimin e depozitave të reja të pasiguruara.

3. Banka urë kryen veprimtari kredidhënëse të kufizuar dhe me rrezik të ulët, si dhe ndaj klientëve të rregullt të bankës me probleme.

4. Banka urë mund të vazhdojë përmbushjen e projekteve dhe/ose angazhimeve të ndërmarra më përpara nga banka me probleme.



### KREU III INVESTIMET E BANKËS URË

#### Neni 12 **Aktivet**

1. Banka urë, brenda 40 ditëve pas licencimit të saj, kryen inventarin për të identifikuar dhe vlerësuar realisht aktivet e transferuara nga banka me probleme.

2. Banka urë, brenda 60 ditëve pas licencimit të saj, mund të kthejë tek banka e vendosur në kujdestari/likuidim aktivet të cilat i janë transferuar dhe që rezultojnë si aktive të cilat klasifikohen në nenin 10, pika 4 të kësaj rregulloreje. Ky veprim miratohet paraprakisht nga Banka e Shqipërisë.

3. Banka urë, gjatë procesit të identifikimit dhe vlerësimit të aktiveve të saj, mbështetet në kushtet aktuale të tregut dhe përlogarit fondet rezervë për humbjet.

4. Banka urë, për ushtrimin e veprimtarisë së lejuar në mënyrë të sigurt dhe të qëndrueshme, duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e saj dhe pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të investojë një pjesë të mjeteve të saj të lira në një nga aktivet e mëposhtme:

a) depozitë në Bankën e Shqipërisë;

b) tituj të emtuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë ose nga Banka e Shqipërisë;

c) aktive me rrezik të ulët, sipas përcaktimit në aktet rregullative përkatëse të Bankës së Shqipërisë;

d) aktive të tjera me rrezik të ulët.

#### Neni 13 **Depozitat**

1. Interesat e depozitave të transferuara nga banka me probleme tek banka urë, ruhen për një afat 20-ditor.

2. Banka urë, me kalimin e afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, mund të përcaktojë normat e reja të interesit për depozitën/at e transferuara nga banka me probleme.

3. Në rastin e tërheqjes së depozitave të transferuara tek banka urë, pas afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, depozituesi/t nuk përfiton/jnë interesin e depozitës.

#### Neni 14 **Likuiditeti**

1. Banka e Shqipërisë shqyrton gjendjen e likuiditetit të bankës me probleme gjatë fazës përgatitore, për të përcaktuar nevojat për likuiditet të bankës urë.

2. Banka e Shqipërisë monitoron në vazhdimësi nivelet e likuiditetit për të përcaktuar nëse banka urë mund të plotësojë ose jo, nevojat e veta për likuiditet.

3. Banka urë mund të rivendosë linjat e kreditit dhe/ose marrëdhëniet me bankat e tjera korrespondente të bankës me probleme, për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm.

## KREU IV ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I BANKËS URË

### Neni 15 **Organet e bankës urë**

1. Banka urë ka të njëjtat organe me ato të përcaktuara në nenin 32 të ligjit “Për bankat”, me përjashtim të rasteve kur Banka e Shqipërisë mund të vendosë ndryshe për struktura më të thjeshta. Organet e bankës urë përcaktohen në vendimin për krijimin ose në statutin e saj.

2. Funksionet e organeve të bankës urë janë të njëjta me ato të përcaktuara në dispozitat e ligjit “Për bankat”, me përjashtim të rasteve kur Banka e Shqipërisë vendos ndryshe në vendimin e krijimit të bankës urë, në miratimin e statutit të kësaj banke apo ndryshimeve të mëvonshme të tij.

### Neni 16 **Parimet e administrimit të bankës urë**

1. Drejtimi i bankës urë synon ruajtjen e madhësisë dhe jo shtrirjen dhe zgjerimin e rrjetit të saj.

2. Drejtimi i bankës urë synon ruajtjen dhe rritjen e vlerës së aktiveve të bankës dhe të fitimit të saj.

3. Administratorët e bankës urë njohin profilin e rrezikut dhe sigurojnë që nivelet e kapitalit të mbulojnë mjaftueshëm rrezikun.

### Neni 17 **Administratorët e bankës urë**

1. Administrimi i bankës urë kryhet nga administratorët e emëruar nga Banka e Shqipërisë.

2. Banka e Shqipërisë miraton çdo ndryshim të administratorëve të bankës urë dhe mund t’i shkarkojë ata (administratorët) në çdo kohë.

3. Kriteret dhe kushtet për emërimin e administratorëve të bankës urë janë të njëjta me ato të parashikuara në ligjin “Për bankat” dhe në rregulloren “Mbi parimet bazë të drejtimit të bankave dhe degëve të bankave të huaja dhe kriteret për miratimin e administratorëve të tyre”.

## KREU V SHITJA E BANKËS URË

### Neni 18 **Transferimi i kapitalit ose i aktiveve dhe detyrimeve të bankës urë**

1. Banka urë, në bashkëpunim me Grupin Mbikëqyrës, harton një strategji shitjeje, e cila duhet të marrë parasysh kryesisht faktorët e mëposhtëm:

- a) përbërjen e aktiveve dhe detyrimeve të bankës urë;
- b) kushtet ekonomike dhe konkurruese të bankës në tregun përkatës;
- c) eksperiencat e mëparshme në tregtimin e aktiveve dhe detyrimeve të një shoqërie (bankë, subjekt financiar jobankë, etj.);
- d) çdo informacion tjetër të rëndësishëm;
- e) si do të tregtohet banka urë (pjesërisht apo e gjitha, etj.);
- f) cilat lloje të aktiveve të bankës urë duhet t’u ofrohen blerësve të ardhshëm;
- g) çmimin e shitjes së aktiveve (ku do të bazohet çmimi i shitjes së aktiveve etj.).

2. Blerësi të cilit mund t’i transferohet kapitali ose aktivet dhe detyrimet e bankës urë, është një bankë vendase ose e huaj.



3. Banka e cila kërkon të blejë kapitalin, aktivet dhe detyrimet e bankës urë, duhet të ketë fonde të mjaftueshme për të kryer këtë transaksion, i cili nuk duhet të cenohet gjendjen financiare të saj.

4. Administratorët e bankës urë, pas përfundimit të hartimit të strategjisë dhe të strukturës së shitjes së kapitalit, aktiveve dhe detyrimeve të bankës urë, vendosin në dispozicion të bankave blerëse informacionin e mëposhtëm:

- a) vendndodhjen gjeografike të bankës urë;
- b) mjedisin konkurrues;
- c) kushtet e përgjithshme financiare të bankës urë;
- d) totalin e aktiveve;
- e) nivelin e kapitalit; dhe
- f) vlerësimin e bankës urë nga Banka e Shqipërisë.

5. Administratorët e bankës urë, bazuar në listën e blerësve potencialë dhe pas miratimit paraprak të Bankës së Shqipërisë, mund të vendosin kontakte dhe/ose të kryejnë takime me blerësit potencialë për t'i informuar ata mbi të dhënat, strukturën, etj. për sa lidhet me shitjen e bankës urë.

6. Bankat, të cilat do të konsiderohen nga administratorët e bankës urë si blerës potencialë, nënshkruajnë një marrëveshje konfidencialiteti mbi negociatat e mundshme për tregtimin e aktiveve dhe detyrimeve të bankës urë.

7. Në rast se vlera e detyrimeve të bankës urë, që do të transferohen është më e madhe se vlera e aktiveve, diferenca ndërmjet këtyre të dyjave është pjesë e çmimit të shitjes që merr përsipër blerësi.

8. Kontrata e shitjes së kapitalit, aktiveve dhe detyrimeve të bankës urë tek një bankë tjetër, duhet të miratohet paraprakisht nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

## KREU VI RAPORTIMET DHE MBIKËQYRJA E BANKËS URË

### Neni 19 **Raportimet**

1. Drejtori i bankës urë mban kontakte të vazhdueshme me Grupin Mbikëqyrës të krijuar nga Banka e Shqipërisë.

2. Drejtori i bankës urë raporton çdo 2 muaj tek Grupi Mbikëqyrës, në lidhje me ecurinë e gjendjes financiare të bankës urë, si dhe të masave dhe projekteve për shitjen e bankës urë.

### Neni 20 **Mbikëqyrja e bankës urë**

1. Banka urë respekton kërkesat ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi, në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe/ose financiare, të përcaktuara në vendimin e krijimit të saj dhe/ose sipas ndryshimeve të mëvonshme.

2. Banka e Shqipërisë mbikëqyr bankën urë, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për bankat” si dhe me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.

3. Banka e Shqipërisë, sipas rastit, mund të marrë ndaj bankës urë masat mbikëqyrëse që gjykon të nevojshme, në përputhje me dispozitat e ligjit “Për bankat” dhe/ose kuadrit rregullativ mbikëqyrës të nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tij.

KREU VII  
MBYLLJA DHE LIKUIDIMI I BANKËS URË

Neni 21  
**Mbyllja e bankës urë**

1. Banka urë mbyllet kur përfundon afati i përcaktuar në vendimin për krijimin e saj.
2. Banka urë mbyllet përpara afatit, kur ka transferuar ose shitur të gjitha aktivet dhe detyrimet tek një bankë tjetër vendase dhe/ose e huaj, ose kur kapitali i saj është blerë nga subjektet e interesuara.
3. Vendimi për mbylljen e bankës urë miratohet paraprakisht nga Banka e Shqipërisë.
4. Banka urë mbyllet me vendim të Bankës së Shqipërisë edhe në rastet kur vlera totale e aktiveve bie si pasojë e tërheqjes së depozitave nga klientët e saj.

Neni 22  
**Likuidimi i bankës urë**

1. Banka e Shqipërisë, pas mbylljes së bankës urë në përputhje me rastet e përcaktuara në nenin 21 të kësaj rregulloreje, revokon licencën e bankës urë.
2. Me revokimin e licencës së bankës urë, aktivet dhe detyrimet e patransferuara ose të pashitura, vendosen në likuidim nga Banka e Shqipërisë.
3. Grupi Mbikëqyrës, i cili ka monitoruar dhe asistuar administratorin/ët e bankës urë, asiston edhe likuidatorin e kësaj banke, në përputhje me detyrat e tij të përcaktuara në manualin “Për kujdestarinë dhe likuidimin”.
4. Likuidimi i aktiveve dhe detyrimeve të patransferuara ose të pashitura të bankës urë kryhet në përputhje me kriteret, kushtet dhe procedurat e përcaktuara në dispozitat e ligjit “Për bankat” dhe/ose në aktet rregullative të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij nga Banka e Shqipërisë.

KREU VIII  
TË TJERA

Neni 23  
**Konfidencialiteti**

1. Procesi i transferimit të aktiveve dhe detyrimeve nga banka me probleme tek banka urë, si dhe transferimi i tyre tek një bankë tjetër vendase ose e huaj, është një proces që zhvillohet në fshehtësi të lartë, me qëllim shmangien e humbjeve të mëtejshme gjatë këtij procesi.
2. Palët në transaksionet përkatëse janë të detyruara për ruajtjen e sekretit profesional, si dhe të konfidencialitetit të informacionit të marrë gjatë procesit të krijimit, funksionimit, si dhe shitjes së bankës urë.

VENDIM  
Nr. 28, datë 16.5.2012

**PËR NJË SHITESË NË RREGULLOREN  
“PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BANKAVE DHE DEGËVE  
TË BANKAVE TË HUAJA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43 shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 79 pika 3 të ligjit nr. 9267, datë





29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

#### VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.03.2009 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar, pas pikës 7 të nenit 18, të shtohet pika 8, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

1.1 Banka mund të ushtrojë veprimtarinë e ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime, të parashikuara në ligjin nr. 9267, datë 29.7.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, pas marrjes së miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë dhe përmbushjes së kushteve ligjore të parashikuara në ligj, për ushtrimin e kësaj veprimtarie. Në këtë rast, banka paraqet në Bankën e Shqipërisë:

a) kërkesën për lejimin e përfshirjes së bankës në veprimtarinë financiare, duke shpjeguar fushën e veprimtarisë që do të kryejë, nivelin e rrezikut të ndërmarrë, si dhe kategorinë e klientëve të bankës të cilëve do t’u ofrohet ky shërbim;

b) vendimin e organit përkatës vendimmarrës të bankës ose të bankës së huaj në rastin e degës së bankës së huaj, për miratimin e ushtrimit të veprimtarisë financiare;

c) projektin e ndryshuar të statutit, nëse statuti përmban një dispozitë që përcakton objektin e veprimtarisë;

d) parashikimet e bankës ose të degës së bankës së huaj, për përfitueshmërinë e kryerjes së një veprimtarie të tillë;

e) procedurat dhe rregullat e brendshme të bankës, lidhur me kryerjen dhe kontrollin e kësaj veprimtarie.

1.2 Pika 8 në këtë nen, bëhet pika 9.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënive me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI  
**Ardian Fullani**

#### VENDIM

Nr. 29, datë 16.5.2012

### **PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “MBI MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR MBAJTUR NË BANKËN E SHQIPËRISË NGA BANKAT”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43 shkronja “c”, të nenit 19 dhe nenit 20 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar; si dhe të nenit 67 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Bankat zbatojnë dispozitat e rregullores së përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për periudhën bazë pasardhëse të muajit kalendarik në të cilin ky vendim hyn në fuqi.

3. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Mbikëqyrjes, Departamenti i Emisionit, si dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, si dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr. 43, datë 16.07.2008 i Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e rregullores “Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

KRYETARI  
**Ardian Fullani**

**RREGULLORE**

**MBI MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR TË MBAJTUR NË BANKËN E SHQIPËRISË  
NGA BANKAT**

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

**Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për llogaritjen, raportimin, mbajtjen, përdorimin dhe remunerimin e rezervës së detyruar në Bankën e Shqipërisë.

Neni 2

**Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe në përputhje me:

- a) ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- b) ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- c) vendimin e Këshillit Mbikëqyrës për miratimin e rregullores “Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare”; dhe
- d) akteve të tjera nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

Neni 3

**Objektivi i mbajtjes së rezervës së detyruar**

Rezerva e detyruar është instrument i politikës monetare të Bankës së Shqipërisë, e cila synon rregullimin e likuiditetit të sistemin bankar dhe stabilizimin e normave të interesit në tregun e parasë.



#### Neni 4 Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- a) “Periudha bazë” është çdo muaj kalendarik, fundi i të cilit shërben për monitorimin e bazës së rezervës së detyruar, me qëllim llogaritjen e rezervës së detyruar.
- b) “Periudha e mbajtjes” është periudha në të cilën bankat mbajnë rezervën e detyruar në Bankën e Shqipërisë.
- c) “Baza e reserves” është bashkësia e detyrimeve të një banke, e vrojtuar në ditën e fundit të periudhës bazë, për të cilën do të mbahet rezervë e detyruar.
- d) “Rezerva e detyruar” është niveli minimal i rezervës që një bankë është e detyruar të mbajë pranë Bankës së Shqipërisë. Rezerva e detyruar llogaritet si prodhim i bazës së rezervës me normën e rezervës së detyruar.
- e) “Llogaria reserve” është llogaria e bankës pranë Bankës së Shqipërisë.
- f) “Norma e rezervës së detyruar” është përqindja e bazës së rezervës së detyruar.
- g) “Banka” janë bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga Banka e Shqipërisë.
- h) “Remunerimi” është shuma e interesit që paguhet nga Banka e Shqipërisë për bankat, për rezervën e detyruar të mbajtur nga këto të fundit në Bankën e Shqipërisë.
- i) “Sistemi i unifikuar raportues (SRU)” është tërësia e formularëve të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë, sipas të cilëve bankat i raportojnë Bankës së Shqipërisë në bazë dhe për zbatim të nenit 47, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- j) “Gjoba” është shuma monetare në formë kamatëvonese, që banka dhe dega e bankës së huaj detyrohet të paguajë, për mosplotësimin e rezervës së detyrueshme sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
- k) “Cash në kujdestari” është depozitimi i kartëmonedhave dhe i monedhave metalike për ruajtje pranë Bankës së Shqipërisë.

## KREU II LLOGARITJA DHE RAPORTIMI I REZERVËS SË DETYRUAR

#### Neni 5 Subjektet e detyruara për të mbajtur rezervë të detyruar

1. Të gjitha bankat duhet të mbajnë rezervë të detyruar pranë Bankës së Shqipërisë sipas dispozitave të kësaj rregulloreje.
2. Banka raporton për rezervën e detyruar në momentin e dhënies së licencës nga Banka e Shqipërisë sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore edhe në qoftë se baza e rezervës së saj është zero.
3. Përfshihen nga detyrimi i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni:
  - a) bankat, të cilat janë vendosur në likuidim; dhe
  - b) bankat, gjatë mbylljes përfundimtare të aktivitetit të tyre sipas dispozitave të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si pasojë e revokimit të licencës së tyre.

#### Neni 6 Baza e rezervës

1. Baza e rezervës përfshin detyrimet që rezultojnë nga pranimi i fondeve nga bankat, të pasqyruara në bilancin kontabël të tyre, në lekë dhe në valutë.
2. Përfshihen nga baza e rezervës kategoritë e mëposhtme të detyrimeve:

- a) detyrimet ndërmjet bankave (depozita me afat dhe llogaritë rrjedhëse që bankat kanë ndërmjet tyre);
- b) detyrimet ndaj Bankës së Shqipërisë;
- c) detyrimet ndaj Qeverisë dhe organeve të administratës publike;
- d) detyrimet e krijuara për mbulimin e letër-kredive;
- e) detyrimet e krijuara nga bllokimi i fondeve për garanci; dhe
- f) llogaritë *escrow*.

Pjesë e kësaj rregulloreje është dhe aneksi 1 me pasqyrën e llogarive të bilancit kontabël, të përfshira në bazën e rezervës.

3. Baza e rezervës llogaritet sipas të dhënave të bilancit kontabël të bankave në ditën e fundit të muajit kalendarik, që i paraprin muajit në të cilin fillon periudha e mbajtjes të rezervës së detyruar.

4. Valutat, në të cilat shprehet baza e rezervës që rrjedh nga detyrimet e bankave në valutë, janë euro dhe dollari amerikan.

5. Të gjitha detyrimet e bankave në valuta të tjera nga ato të përmendura në pikën 4 të këtij neni konvertohen në euro, me kursin fiks të ditës së fundit të periudhës bazë, të publikuar nga Banka e Shqipërisë.

#### Neni 7

##### **Norma e rezervës së detyruar**

1. Norma e rezervës së detyruar është 0 (zero) për qind për kategoritë e mëposhtme të detyrimeve:

- a) depozita me afat maturimi fillestar mbi 2 vjet;
- b) certifikatat e depozitave me afat maturimi fillestar mbi 2 vjet;
- c) marrëveshjet e riblerjes/të anasjellta të riblerjes.

2. Norma e rezervës së detyruar për të gjitha kategoritë e tjera të detyrimeve përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe iu njoftohet bankave të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara fillimit të periudhës së mbajtjes të rezervës së detyruar.

#### Neni 8

##### **Mënyra e llogaritjes së rezervës së detyruar**

1. Niveli i rezervës së detyruar që secila nga bankat mban gjatë periudhës së mbajtjes, llogaritet duke aplikuar normën e rezervës së detyruar për çdo kategori të detyrimeve sipas përcaktimit në nenin 7 të kësaj rregulloreje.

2. Shifrat e bazës së rezervës dhe të rezervës së detyruar raportohen të plota, pa shifra pas presjes dhjetore.

#### Neni 9

##### **Raportimi i rezervës së detyruar**

1. Raportimi për rezervën e detyruar bëhet në përputhje me formën e përcaktuar në aneksin 1, bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

2. Detyrimet e bankave në valuta të tjera nga ato të përcaktuara në nenin 6, pika 4 të kësaj rregulloreje, përfshihen në bazën e rezervës së detyruar në euro dhe gjithashtu, raportohen edhe në një pasqyrë të veçantë për secilën monedhë, sipas formatit së paraqitur në aneksin nr. 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje.

3. Bankat dorëzojnë në Bankën e Shqipërisë pasqyrën(at) e llogaritjes të rezervës së detyruar në lekë dhe në valutë, sipas anekseve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, brenda datës 15 të muajit në të cilin fillon periudha e mbajtjes së rezervës së detyruar.



4. Pasqyra e llogaritjes së rezervës së detyruar dorëzohet në Bankën e Shqipërisë nëpërmjet protokollit me shënimin: Banka e Shqipërisë, Departamenti i Operacioneve Monetare, Sektori i Operacioneve:

a) e nënshkruar nga personi që e ka përgatitur; e nënshkruar nga përfaqësuesi i bankës, i cili ka nënshkrim të autorizuar dhe e vulosur me vulën e bankës;

b) e shoqëruar me shkresë përcjellëse të nënshkruar nga përfaqësuesi i bankës, i cili ka nënshkrim të autorizuar dhe e vulosur me vulën e bankës.

Data e marrjes në dorëzim të pasqyrës nga Banka e Shqipërisë, është data që merret në konsideratë për vlerësimin, nëse raportimi është brenda afatit apo jo.

5. Pasqyra sipas anekseve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje, dërgohet(n) në Bankën e Shqipërisë edhe në mënyrë elektronike në adresën(at) që do të bëhet(n) e(të) njohur(a) nga Departamenti i Operacioneve Monetare i Bankës së Shqipërisë.

### KREU III

#### MBAJTJA, PËRDORIMI DHE REMUNERIMI I REZERVËS SË DETYRUAR

##### Neni 10

##### **Mbajtja e rezervës së detyruar**

1. Bankat mbajnë rezervën e detyruar në llogaritë e tyre rezervë në lekë dhe në valutë (në euro dhe në dollarë amerikanë) në Bankën e Shqipërisë.

2. Bankat mund të mbajnë rezervën e detyruar në lekë edhe në formën cash në kujdestari pranë Bankës së Shqipërisë. Mbajtja e rezervës së detyruar në lekë në formën cash në kujdestari mund të jetë e pjesshme ose e plotë.

Pra për Lekun:  $RD = RDLL + RDC$

Ku: RDLL – është vlera e rezervës së detyruar e mbajtur në llogari;

RDC – është vlera e rezervës së detyruar e mbajtur në formën cash në kujdestari.

3. Kërkesa e bankës për të mbajtur rezervën e detyruar në lekë në formën cash në kujdestari shqyrtohet nga Komiteti i Zbatimit të Politikës Monetare. Komiteti shprehet me vendim në përfundim të shqyrtimit. Në vendim ndër të tjera jepet kohëzgjatja, si dhe pjesa e rezervës së detyruar që do të mbahet në formën cash në kujdestari.

4. Periudha e mbajtjes së rezervës së detyruar është 1 (një) muaj. Ajo fillon nga dita e 24-të e muajit që pason periudhën bazë dhe përfundon në ditën e 23-të të muajit pasues.

5. Nëse data 24 është ditë pushimi zyrtar në Republikën e Shqipërisë, atëherë:

a) veprimet për mbajtjen e rezervës së detyruar kryhen në ditën pasuese të punës;

b) periudha e mbajtjes së rezervës ekzistuese zgjatet deri në ditën paraardhëse të ditës së kryerjes së veprimeve për mbajtjen e rezervës së detyruar, sipas pikës “a” më sipër.

6. Nëse data 24 është pushim zyrtar në juridiksionin përkatës për secilën valutë (për euron ose për dollarin amerikan), veprimet për mbajtjen e rezervës së detyruar në këtë valutë (për euron ose dollarin amerikan) kryhen sipas pikës 3 të këtij neni.

##### Neni 11

##### **Përdorimi i rezervës së detyruar në lekë**

1. Gjatë periudhës së mbajtjes, bankat mund të përdorin rezervën e detyruar në lekë, me kusht që mesatarja e gjendjes së llogarisë rezervë ditën e fundit të periudhës së mbajtjes të mos jetë nën nivelin e rezervës së detyruar.

2. Masa e rezervës së detyruar, e cila mund të përdoret në një ditë nga bankat shprehet në përqindje të rezervës së detyruar dhe përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë si dhe njoftohet të paktën 30 (tridhjetë) ditë pune përpara fillimit të periudhës së mbajtjes.

3. Bankat, që mbajnë pjesërisht rezervën e detyruar në lekë në formën cash në kujdestari, mund të vijojnë të përdorin gjendjen në llogarinë rezervë deri në nivelin zero të saj, por gjithmonë duke zbatuar masën e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

4. Bankat të cilat kanë vendosur rezervën e detyruar në lekë si garanci më shumë se masa e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, përjashtohen nga e drejta e përdorimit të rezervës së detyruar në lekë.

5. Bankat nuk mund të përdorin rezervën e detyruar që vendoset si kolateral dhe/ose rezervën e detyruar që mbahet në formën cash në kujdestari, pavarësisht përdorimit/vendosjes së saj të plotë apo të pjesshme.

#### Neni 12

#### **Remunerimi i rezervës së detyruar**

1. Banka e Shqipërisë remuneron bankat për mbajtjen e rezervës së detyruar në lekë dhe në valutë, për periudhën e mbajtjes së saj. Remunerimi aplikohet vetëm për rezervën e detyruar që mbahet në llogarinë rezervë në Bankën e Shqipërisë dhe jo për rezervën e detyruar që mbahet në formën cash kujdestari apo atë pjesë që vendoset si garanci.

2. Interesi për remunerimin e rezervës së detyruar kalohet në llogaritë rezervë të bankave në ditën pasardhëse të ditës së fundit të periudhës së mbajtjes të rezervës së detyruar.

3. Interesi për remunerimin e rezervës së detyruar llogaritet deri në dy shifra pas presjes dhjetore, sipas formulave të mëposhtme:

a) për rezervën e detyruar në lekë 
$$I = \frac{RDLL * NI * d}{365};$$

b) për rezervën e detyruar në valutë 
$$I = \frac{RD * NI * d}{360}$$

Ku:

I = interesi i paguar për remunerimin e rezervës së detyruar për periudhën e mbajtjes;

RD = niveli i rezervës së detyruar për periudhën e mbajtjes të rezervës së detyruar;

NI = norma e remunerimit të rezervës së detyruar;

d = kohëzgjatja e periudhës të mbajtjes të rezervës së detyruar, e shprehur në ditë.

4. Normat e remunerimit të rezervës së detyruar në lekë dhe në valutë përkatësisht, përcaktohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë dhe njoftohen të paktën 30 (tridhjetë) ditë pune përpara fillimit të periudhës së mbajtjes.

#### KREU IV

#### **MASAT PËR MOSPËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE PËR REZERVËN E DETYRUAR**

#### Neni 13

#### **Masat për mosplotësim të rezervës së detyruar**

1. Nëse në fund të periudhës së mbajtjes, gjendja mesatare e fondeve në llogarinë rezervë në lekë dhe e cash-it në kujdestari, është më e vogël se niveli i rezervës së detyruar në lekë, atëherë Banka e Shqipërisë aplikon interes gjorbë me normë të përcaktuar në nenin 16, pika 1 për shumën e mosplotësimit të rezervës së detyruar për periudhën përkatëse të mbajtjes së rezervës së detyruar sipas formulës së mëposhtme:



$$I_{gj} = \left| \frac{\left( \frac{\sum GJL + RDC}{d} - RD \right) * NI_{gj} * d}{365} \right|$$

Ku:

$I_{gj}$  = interesi gjorbë i aplikuar;

GJL = gjendja ditore e llogarisë rezervë gjatë periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar;

RDc = është vlera e rezervës së detyruar në lekë e mbajtur në formën cash në kujdestari;

RD = niveli i rezervës së detyruar për periudhën e mbajtjes të rezervës së detyruar;

d = kohëzgjatja e periudhës së mbajtjes të rezervës së detyruar e shprehur në ditë;

$NI_{gj}$  = norma e interesit gjorbë.

2. Nëse në ditën e parë të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar në euro dhe/ose në dollarë amerikanë, gjendja e llogarisë rezervë të bankës sipas monedhave përkatëse është më e vogël se niveli i rezervës së detyruar, atëherë Banka e Shqipërisë aplikon interes gjorbë me normë të përcaktuar në nenin 16, pika 2 për shumën e mosplotësimit të rezervës së detyruar në euro dhe/ose në dollarë amerikanë për periudhën e mosplotësimit të saj sipas formulës së mëposhtme:

$$I_{gj} = \left| \frac{(GJL - RD) * NI_{gj} * d}{360} \right|$$

Ku:

$I_{gj}$  = interesi gjorbë i aplikuar;

GJL = gjendje e llogarisë rezervë të bankës në euro dhe/ose në dollarë amerikanë në ditën e parë të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar;

RD = niveli i rezervës së detyruar për periudhën e mbajtjes të rezervës së detyruar;

$NI_{gj}$  = norma e interesit gjorbë;

d = kohëzgjatja e periudhës së mosplotësimit të rezervës së detyruar, e shprehur në ditë.

#### Neni 14

#### Masat për mosraportim brenda afatit

1. Në rast se banka nuk përmbush detyrimin për raportimin e rezervës së detyruar brenda afatit të përcaktuar në nenin 9 pika 3 e kësaj rregulloreje, atëherë niveli i rezervës së detyruar përcaktohet në masën 10 (dhjetë) për qind më i lartë se niveli i rezervës së detyruar të bankës në raportimin e fundit të saj, por jo më i lartë se 700 milionë lekë (ose ekuivalentja e kësaj shume në euro dhe në dollarë).

2. Në rast se niveli faktik, por i paraportuar i rezervës së detyruar, i verifikuar nga Banka e Shqipërisë sipas nenit 15, pika 1 rezulton më i lartë se niveli i përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, atëherë veprohet në përputhje me nenin 15, pika 2, shkronja (a) të kësaj rregulloreje.

#### Neni 15

#### Masat për raportim të gabuar

1. Banka e Shqipërisë verifikon saktësinë e raportimit të rezervës së detyruar në përputhje me të dhënat e raportuara në SRU dhe/ose nëpërmjet inspektimeve në vend të bankës.

2. Në rast se, pas periudhës së mbajtjes së rezervës, verifikohet mospërputhja në vlerë monetare më shumë se 1,000 (një mijë) lekë (ose ekuivalentja e shumës në euro dhe në dollarë) e të

dhënave të raportuara për rezervën e detyruar me të dhënat e raportuara në SRU dhe/ose me të dhënat e marra nga inspektimet në vend të bankës atëherë:

a) Për raportimin e rezervës së detyruar në nivel më të ulët, aplikohet interes gjorbë sipas normës së përcaktuar në nenin 16, për diferencën midis nivelit të saktë të rezervës së detyruar dhe asaj të raportuar e shtrirë për periudhën e mbajtjes respektive sipas formulës së mëposhtme:

$$I_{gj} = \frac{(RD_s - RD_g) * NI_{gj} * d}{vk}$$

Ku:

$I_{gj}$  = interesi gjorbë i aplikuar;

$RD_s$  = niveli i saktë, i verifikuar i rezervës së detyruar (në lekë, euro, dollarë amerikanë);

$RD_g$  = niveli i raportuar gabim i rezervës së detyruar (në lekë, euro, dollarë amerikanë);

$NI_{gj}$  = norma e interesit gjorbë;

$d$  = kohëzgjatja e periudhës të mbajtjes të rezervës së detyruar, e shprehur në ditë;

$vk$  = viti kalendarik; 365 ditë për rezervën e detyruar në lekë dhe 360 ditë për rezervën e detyruar në valutë.

b) Për raportimin e rezervës së detyruar në nivel më të lartë, banka është e detyruar t'i kthejë Bankës së Shqipërisë interesin e përfituar nga remunerimi i shtesës të rezervës së raportuar.

3. Në rast se mospërputhja e të dhënave të raportuara për rezervën e detyruar me të dhënat e raportuara në SRU dhe/ose me të dhënat e marra nga inspektimet, verifikohet nga Banka e Shqipërisë përpara fillimit të periudhës së mbajtjes të rezervës së detyruar, atëherë me njoftimin nga Banka e Shqipërisë, banka është e detyruar të sjellë raportimin e saktë përpara fillimit të periudhës së mbajtjes. Në rast se banka nuk paraqet raportimin e saktë përpara fillimit të periudhës së mbajtjes, atëherë vepohet sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Në rast se banka njofton Bankën e Shqipërisë për gabime në raportimin e rezervës së detyruar dhe paraqet raportimin e saktë përpara fillimit të periudhës së mbajtjes të rezervës së detyruar përkatëse, Banka e Shqipërisë nuk merr masa kundrejt bankës në rast se banka nuk ka raportuar për gabime më shumë se 1 (një) herë brenda vitit kalendarik. Në rast se gabimet raportohen pas fillimit të periudhës së mbajtjes, vepohet sipas pikës 2 të këtij neni.

#### Neni 16 Interesi gjorbë

1. Interesi gjorbë i aplikuar nga Banka e Shqipërisë për rastet e mosplotësimit të rezervës së detyruar në lekë, të parashikuara në nenin 13, pika 1 dhe në nenin 15, pika 2, shkronja "a" të kësaj rregulloreje është i barabartë me 600 (gjashtëqind) pikë bazë më i lartë se norma bazë e interesit të Bankës së Shqipërisë në ditën e fundit të periudhës bazë, por jo më i lartë se dyfishi i normës bazë.

2. Interesi gjorbë i aplikuar nga Banka e Shqipërisë për rastet e mosplotësimit të rezervës së detyruar në valutë të parashikuara në nenin 13, pika 2 dhe në nenin 15, pika 1 të kësaj rregulloreje është i barabartë me:

a) për rezervën e detyruar në euro, 200 (dyqind) pikë më i lartë se norma bazë e interesit të Bankës Qendrore Evropiane, në ditën e fundit të periudhës bazë, por jo më i lartë se dyfishi i normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë;

b) për rezervën e detyruar në dollarë, 200 (dyqind) pikë më i lartë se norma bazë e interesit të Bankës Federale të SHBA në ditën e fundit të periudhës bazë por jo më i lartë se dyfishi i normës bazë të interesit të Bankës së Shqipërisë.





Neni 17

**Njoftimi për aplikimin e interesit gjobë**

Banka e Shqipërisë njofton menjëherë bankën ndaj të cilës aplikohet interesi gjobë për gjobat e vendosura në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje. Njoftimi përmban të dhëna dhe argumente mbi të cilat mbështetet aplikimi i gjobës.

Neni 18

**Veprimet në kundërvajtje dhe/ose shkeljet e dispozitave ligjore dhe nënligjore**

Mosparaqitja e raportit për rezervën e detyruar në afatin dhe formatin e përcaktuar në nenin 9, pikat 1 deri në 4, mospërputhja e verifikuar e të dhënave sipas nenit 15, pikat 1 deri në 3 dhe përsëritja e njoftimit për gabime më shumë se numri i përcaktuar në nenin 15, pika 4 konsiderohen veprim në kundërvajtje dhe/ose shkelje e dispozitave ligjore dhe nënligjore sipas nenit 76, pika 1 shkronja “d” të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 19

**E drejta e ankimimit**

Banka e cenuar nga çdo akt administrativ i Bankës së Shqipërisë sipas nenit 18 të kësaj rregulloreje, ka të drejtën e ankimimit në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara në nenin 93 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 20

**Dispozitë e fundit**

Anekset 1 dhe 2 bashkëlidhur kësaj rregulloreje janë pjesë përbërëse e saj.

(emri i bankës)

ANEKSI 1

(emri i departamentit)

Pasqyra e llogaritjes së rezervës së detyruar në LEKË, USD dhe EURO

KATEGORITE E PASIVEVE	LEKË			Norma e rezervës së detyruar	Rezerva e detyruar në LEKE	USD			Norma e rezervës së detyruar	Rezerva e detyruar në USD	EURO			Norma e rezervës së detyruar	Rezerva e detyruar në EURO
	Rezident	Jorezident	TOTALI			Rezident	Jorezident	TOTALI			Rezident	Jorezident	TOTALI		
27 <b>Detyrime ndaj klientëve për llogaritë rrjetëse dhe depozitat</b>															
271 <i>Llogari rrjedhëse</i>															
2711 Individë															
2712 Njësi tregtare dhe industriale private															
2713 Njësi tregtare dhe industriale publike															
2714 Punonjës të bankës															
2717 Klientë të tjerë															
272 <i>Llogari depozitash pa afat</i>															
2721 Individë															
2722 Njësi tregtare dhe industriale private															
2723 Njësi tregtare dhe industriale publike															
2724 Punonjës të bankës															
2727 Klientë të tjerë															
273 <i>Llogari depozitash me afat</i>															
2731 Individë															
2732 <i>Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
2732 Njësi tregtare dhe industriale private															
2732 <i>Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
2732 Njësi tregtare dhe industriale publike															
2732 <i>Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
2732 Punonjës të bankës															
2732 <i>Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
2732 Klientë të tjerë															
2732 <i>Depozita me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
2732 Klientë të tjerë															
274 <i>Certifikatat e depozitave</i>															
2741 <i>Certifikatat e depozitave emërore</i>															
27411 Individë															
27412 <i>Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
27412 Njësi tregtare dhe industriale private															
27412 <i>Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
27412 Njësi tregtare dhe industriale publike															
27412 <i>Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
27412 Punonjës të bankës															
27412 <i>Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
27412 Klientë të tjerë															
27412 <i>Certifikatat e depozitave me afat maturimi mbi 2 vjet</i>				0%					0%					0%	
2742 <i>Certifikatat e depozitave të mbajtësit</i>															
27421 Kryegjësja															
34 <i>Letra me vlerë të blera dhe të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes</i>				0%					0%					0%	
342 <i>Letra me vlerë të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes</i>				0%					0%					0%	
TOTALI															

(date)

(punoi: Emri/firma)

Emri/firmaepersonitëautorizuar/vula



**VENDIM**  
**Nr. 37, datë 29.5.2012**

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARIVE**  
**SHTESË NGA BANKA RAIFFEISEN SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 23, pikat 1 dhe 3, të nenit 24, pika 1, shkronja “ç”, të nenit 54, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

**VENDOSI:**

1. Të japë miratimin paraprak për kryerjen nga Banka Raiffeisen sh.a., të veprimtarive financiare shtesë, si më poshtë:
  - a) Faktoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare.
2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, për të bërë ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës të Bankës Raiffeisen sh.a., pas kryerjes së ndryshimit sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritet Evropian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Ardian Fullani**



### Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr. 40/4 prill 2009, në vendimin nr. 204, datë 19.2.2009 “Për shpronësimin e pronarëve, për sipërfaqet takuese, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, në faqen 2106, rreshti me nr. 117

#### Ishte:

117	Haki Peqini	8340	9/282	2,275.60	26094.00	<b>53,379,506.40</b>
-----	-------------	------	-------	----------	----------	----------------------

#### Bëhet:

117	Haki Peqini	8340	9/282	2,275.60	26094.00	<b>59,379,506.40</b>
-----	-------------	------	-------	----------	----------	----------------------

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**  
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.  
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 18.6.2012  
Doli nga shtypi më 19.6.2012

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2012

Çmimi 26 lekë